

Udhëzues për mësuesit
Të parandalojmë

 EKSTREMIZMIN

E DHUNSHËM

Botuar në vitin 2016 nga Organizata për Arsimin Shkencën dhe Kulturën e Kombeve të Bashkuara, 7, place de Fontenoy, 75352 Paris 07 SP, Francë

© UNESCO 2016



Ky botim mund të gjendet në internet, nën Attribution-ShareAlike 3.0 IGO (CC-BY-SA 3.0 IGO) licenca (<http://creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0/igo/>). Duke pëdorur përmbajtjen e këtij botimi, përdoruesit pranojnë të respektojnë kushtet e përdorimit të Bazës së të Dhënave me Akses të Hapur të UNESCO-s (UNESCO Open Access Repository), në adresën (<http://www.unesco.org/open-access/terms-use-ccbysa-en>).

Përmbajtja e materialit dhe mënyra e paraqitjes së tij në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinionit nga ana e UNESCO-s lidhur me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti a zone, të institucioneve të tij ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tij.

Idetë dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë vetëm idetë dhe opinionet e autorëve; ato nuk shprehin domosdoshmërisht idetë dhe opinionet e UNESCO-s dhe as detyrime të saj.

Përktheu: Astrit Dautaj

Fotografia e kopertinës: Shutterstock/Guillermo del Olmo

Hartuar nga: Aurélia Mazoyer

Printuar nga: UNESCO

Shtypur në Francë

Pasqyra e lëndës

Parathënie	5
Falenderime	7
1 . Hyrje	9
2 . Rreth ekstremizmit të dhunshëm	11
2.1. Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi	11
2.2. Ekstremizmi i dhunshëm dhe arsimimi	13
2.3. Shfaqjet lokale të ekstremizmit	15
2.4. Roli i komunitetit, i familjes dhe medias	16
3 . Menaxhimi i diskutimit në klasë	17
3.1. Objektivat	17
3.2. Përgatitja	20
3.3. Diskutimi	22
3.4. Temat për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm	29
3.5. Përmbledhje dhe hapat e mëtejshëm	31

4 . Mesazhet kryesore 33

4.1.	Solidariteti	33
4.2.	Respekt për diversitetin	34
4.3.	Të drejtat e njeriut	35
4.4.	Të mësojmë të jetojmë së bashku	37
4.5.	Përfshirja e të rinjve	38

Shtojca 39

Pyetje të shpeshta	39
Referencat	43

Parathënie

Ky është *Udhëzuesi i Parë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm* përmes arsimit i UNESCO-s. Ky dokument është hartuar në përgjigje të drejtpërdrejtë të nevojave të shteteve anëtare të UNESCO-s, siç shprehet në vendimin e mirënjohur 197/EX 46 të Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s, të marrë në tetor të vitit 2015¹, i cili i bën thirrje organizatës që të rrisë kapacitetin e saj për të ndihmuar shtetet në fuqizimin e përgjigjes që sektori i arsimit duhet t'i japë ekstremizmit të dhunshëm, edhe përmes programeve të Edukimit për Qytetarinë Global të bazuar në të drejtat e njeriut (GCED), dhe që mbajnë parasysh kontekstet kombëtare.

Si i tillë, ky Udhëzues shërben si kontributi i parë i UNESCO-s për zbatimin e Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm² të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, pasi ai lidhet me sektorin e arsimit.

Organizata, krahas këtij udhëzuesi, po zhvillon edhe udhëzues teknik për edukimin e politikëbërësve në ministritë e arsimit. Ky udhëzues synon t'iu ofrojë vendeve një gamë burimesh, të cilat mund të ndihmojnë në ngrijten dhe forcimin e kapaciteteve kombëtare, që janë në gjendje të trajtojnë motivet e ekstremizmit të dhunshëm përmes përgjigjeve gjithëpërfshirëse dhe pragmatike të mbarë sektorit të arsimit.

1 Vendimi Nr. 46, i miratuar në sesionin e 197-të të Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s (197 EX/Vendimi Nr. 46), <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf>

2 Plani i Masave për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm (A/70/674). http://ëëë.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf

Me qëllim që të përshtatet me kontekstet e ndryshme gjeografike dhe social kulturore, ky udhëzues u përgatit pas një procesi të gjerë konsultimesh me ekspertë dhe mësues nga rajone të ndryshme, si dhe testimesh në terren nga aktorë të ndryshëm të sistemit arsimor në vende të përzgjedhura.

Si i tillë, ai mund të përdoret siç është ose si dokument bazë për kontekstualizim të mëtejshëm, i përshtatur dhe i përkthyer për t'iu përgjigjur nevojave specifike të nxënësve.

Falenderime

Udhëzuesi për Mësuesit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm është hartuar nën udhëheqjen e përgjithshme të Soo-Hyang Choi, Drejtor i Divizionit për Përfshirjen, Paqen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm në Zyrën Kryesore të UNESCO-s dhe është koordinuar nga Chris Castle, Karel Fracapane, Alexander Leicht, Alice Mauske, Joyce Poan, Lydia Ruprecht dhe Cristina Stanca-Mustea nga Divizioni. Helen Bond, Profesore e Asociuar për Arsimin në Universitetin e *Hoëard-it*, Washington DC, Shtetet a Bashkuara të Amerikës, ka shërbyer si autore kontribuese për këtë dokument dhe ka redaktuar versionin e parë të dokumentit. Kemi marrë me kënaqësi komentet me shkrim të kolegëve tanë analistë: Lynn Davies, Profesor i Merituar, Profesor për Arsimin Ndërkombëtar në Universitetin e Birmingamit, Mbretëria e Bashkuar; Felisa Tibbitts, Lektore në Kolegjin e Mësuesve në Universitetin e Kolumbias, Nju Jork, Shtetet a Bashkuara të Amerikës; Sara Zeiger, Kërkuese e Lartë e Asociuar në *Hedayah Center*, Emiratet e Bashkuara Arabe; Feriha Peracha, Drejtore në Qendrën *Sabaon*, Pakistan; dhe Steven Lenos nga Rrjeti për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizimit i Bashkimit Evropian. Për më tepër, u jemi mirënjohës kolegëve tanë të UNESCO-s për komentet e dhëna, përkatësisht: Justine Sass (Zyra e UNESCO-s në Bangkok), Jorge Sequeira dhe Elspeth McOmish (Zyra e UNESCO-s në Santiago), Hegazi Idris dhe Maysoun Chehab (Zyra e UNESCO-s në Bejrut), si dhe Florence Migeon (Zyra Kryesore e UNESCO-s). UNESCO-ja dëshiron të falënderojë, po ashtu, mësuesit dhe studentët të cilët kanë marrë pjesë në procesin e testimit në terren për komentet e tyre të dobishme, përkatësisht Kolegjin e Mësuesve të Universitetit të Kolumbias, Nju Jork, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe Koordinatorët e ASPnet-it në Kazakistan dhe Jordani.

Dëshirojmë të shprehim vlerësimin tonë për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara për kontributin e tyre bujar financiar për prodhimin e këtij botimi.

Së fundmi, dëshirojmë të falënderojmë Aurelia Mazoyer, e cila është marrë me faqosjen dhe formatimin, si dhe Martin Wickenden, i cili ka shërbyer si personi ndërlidhës për prodhimin e këtij dokumenti.

1. Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe forcat që nxisin radikalizimin janë ndër sfidat më të vështira të ditëve tona. Ndonëse ekstremizmi i dhunshëm nuk është i kufizuar tek një moshë, seks, grup ose komunitet i caktuar, të rinjtë janë posaçërisht të cenueshëm ndaj mesazheve të ekstremistëve të dhunshëm dhe organizatave terroriste.

Përballë këtyre kërcënimeve, të rinjtë kanë nevojë për të mësuar të përshatshëm dhe të zhvilluar në kohën e duhur, me qëllim që të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që mund t'u vijnë në ndihmë për të ndërtuar imunitetin ndaj një propagande të tillë.

Këto kompetenca mund të zhvillohen me ndihmën e mësuesve që kanë besim tek vetja, të përgatitur mirë, të respektuar dhe që janë në kontakt të vazhdueshëm me të rinjtë.

Duke mbajtur parasysh këtë shqetësim, ky Udhëzues është hartuar për mësuesit e arsimit të ciklit të lartë të arsimit bazë dhe të shkollës së mesme. Ai është hartuar me shpresën që mund të mbështesë përpjekjet e mësuesve që punojnë në mjedise formale dhe joformale arsimit.

Më specifikisht, qëllimi i këtij Udhëzuesi është që të:

- ▶ Të ofrojë këshilla praktike për kohën dhe mënyrën e diskutimit me nxënësit të çështjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.
- ▶ Të ndihmojë mësuesit që të krijojnë në klasë një klimë përfshirëse dhe që nxit respektimin e dialogut, diskutimit të hapur dhe të menduarit kritik.

2. Rreth ekstremizmit të dhunshëm

2.1 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare ose politike radikale³.

Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore. Asnjë shoqëri, komunitet fetar ose pikëpamje botërore nuk është immune ndaj një ekstremizmi të tillë të dhunshëm⁴.

Ekstremizmi i dhunshëm është situata kur ...“ti nuk lejon pikëpamje të ndryshme; kur mendon se pikëpamjet e tua janë të veçanta, kur nuk lejon mundësinë e të ndryshmes dhe kur do t'ua imponosh idetë e tua të tjerëve, nëse është e nevojshme, edhe përmes dhunës.”⁵

³ www.livingsafetogether.gov.au dhe www.dhs.gov/topic/countering-violent-extremism

⁴ Adresa në vijim ofron shembuj të ndryshëm të ekstremizmit të dhunshëm , www.livingsafetogether.gov.au

⁵ Davies, L. 2008. Edukimi kundër Ekstremizmit, *Stoke on Trent and Sterling*. Trentham Books.

<https://www.oise.utoronto.ca/cld/UserFiles/File/DAVIESeducationagainstextremism.pdf>

Megjithëse për termin “radikalizim” ka qëndrime të ndryshme, ai po përdoret për të përkufizuar procesin përmes të cilit një individ ose grup e vlerëson dhunën si legjitime dhe si mjet të dëshirueshëm veprimi.

Mendimi radikal, që nuk e dënon ushtrimin e dhunës për të çuar përpara objektivat politike, mund të shihet si normal dhe i pranueshëm dhe mund të nxitet nga grupet që punojnë brenda kufijve të ligjit.

Për radikalizimin nuk ka një përcaktim ose drejtim të vetëm, sikurse nuk mund të përcaktohet as shpejtësia me të cilën ai mund të përhapet.⁶ As niveli i arsimit nuk duket të shërbejë si faktor i besueshëm për të parashikuar shkallën e ndikimit nga radikalizimi. Megjithatë, pranohet ndikimi i faktorëve⁷ socialë, ekonomikë, psikologjikë dhe institucionalë të cilët të shtyjnë drejt ekstremizmit të dhunshëm. Specialistët i grupojnë këta faktorë në dy kategori kryesore:

- ▶ **“Faktorët shtytës”** që i drejtojnë individët drejt ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: marxhinalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit; mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm; mohimi i të drejtave dhe lirive civile; dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe social-ekonomike.
- ▶ **“Faktorët tërheqës”** që ushqejnë tërheqjen ndaj e ekstremizmit të dhunshëm, si për shembull: ekzistenca e grupeve të mirëorganizuar të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësisë. Grupet mund të joshin anëtarë të rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri. Për më tepër, këto grupe duket se ofrojnë rehati shpirtërore, “ndjenjën e përkatësisë” dhe një rrjet social mbështetës.

6 Davies, L. 2008. Edukimi kundër ekstremizmit: Drejt politizimit kritik të të rinjve. *International Review of Education*, 55 (2/3), f. 183-203. doi:10.1007/s11159-008-9126-8

7 USAID, *Përmbledhje e faktorëve që kanë ndikim mbi ekstremizmin e dhunshëm*. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PBAAA929.pdf; Zeiger, S. dhe Aly, A. 2015. *Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm: zhvillimi i një baze provash për politikën dhe praktikën*. Curtin University, Hedayah.

Së fundi, ekzistojnë faktorë kontekstualë të cilët ofrojnë një terren të favorshëm për shfaqjen e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: shtetet e brishta, mungesa e shtetit të së drejtës, korrupsioni dhe kriminaliteti.

SHEMBUJ TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Neonazistët, Ku Kluks Klani, ekoterrorizmi, Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL), Boko Harami.

SHENJAT E PARA

Sjelljet e mëposhtme mund të jenë shenja të radikalizimit. Nëse vihen re shenja të tilla, familja ose qarqet e ngushta të individit duhet të shqetësohen.

- ▶ Shkëputje e menjëhershme nga familjarët dhe nga shoqëritë afatgjata.
- ▶ Braktisje e menjëhershme e shkollës dhe konflikte me shkollën.
- ▶ Ndryshim në sjelljet që lidhen me ushqimin, veshjen, gjuhën, financat.
- ▶ Ndryshime në qëndrime dhe në sjelljet kundrejt të tjerëve: komente antisociale, kundërshtim i autoritetit, mospranim për bashkëveprim social, shenja të tërheqjes dhe izolimit.
- ▶ Ndjekje e rregullt e faqeve të internetit dhe pjesëmarrje në faqe interneti dhe rrjete të medias sociale, të cilat nuk i dënojnë pikëpamjet radikale ose ekstremiste.
- ▶ **Prirja për t'iu referuar teorive apokaliptike dhe konspirative.**

Burimi : <http://www.stop-djihadisme.gouv.fr/>

2.2 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE ARSIMIMI

Roli i arsimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe deradikalizimin e të rinjve është pranuar globalisht vetëm kohët e fundit.

Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim ishte prezantimi në dhjetor të vitit 2015 i Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm⁸ i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili pranon rëndësinë e cilësisë së arsimit për të trajtuar faktorët që nxisin këtë dukuri.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka theksuar këtë pikë edhe në Rezolutat 2178⁹ dhe 2250, të cilat theksojnë dukshëm nevojën për *“arsimim cilësor për paqe, i cili i pajis të rinjtë me aftësinë për t'u përfshirë në mënyrë konstruktive në strukturat civile dhe proceset gjithëpërfshirëse politike”* dhe u bën thirrje *“të gjithë aktorëve përkatës që të shqyrtojnë mundësinë e ngritjes së mekanizmave për promovimin e kulturës së paqes, tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar, të cilët i përfshijnë të rinjtë dhe shkurajojnë pjesëmarrjen e tyre në aktet e dhunës, terrorizmit, ksenofobisë dhe në të gjitha format e tjera të diskriminimit.”*¹⁰

Në tetor të vitit 2015, Bordi Ekzekutiv i UNESCO-s miratoi një vendim¹¹, i cili pohon njëzëri rëndësinë e arsimit si instrument për të ndihmuar parandalimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe të intolerancës racore dhe fetare, gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në mbarë botën. Pavarësisht nëse ofrohet përmes shkollave, klubeve dhe shoqatave të komunitetit ose në shtëpi, arsimi pranohet si komponent i rëndësishëm i përkushtimit të shoqërisë në përpjekjet për të ulur dhe parandaluar rritjen e ekstremizmit të dhunshëm.

8 [Plani i Masave për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm \(A/70/674\) http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf](http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf)

9 [Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 2178, miratuar në shtator të vitit 2014, http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf](http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf)

10 [Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 2250, miratuar në dhjetor të vitit 2015, http://unov.org/ep-content/uploads/SCR-2250.pdf](http://unov.org/ep-content/uploads/SCR-2250.pdf)

11 [Vendimi Nr. 46 i miratuar në sesionin e 197 të Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s \(197 EX/Vendimi Nr. 46\) http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf)

Këto dokumente nënvizojnë se arsimi mund...

- ▶ T'i ndihmojë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe ato ndërpersonale që u nevojiten për të dialoguar, për t'u përballur me mosmarrëveshjet dhe të mësojnë qasjet paqësore ndaj ndryshimit.
- ▶ T'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, për të shqyrtuar pretendimet, për të qartësuar thashethemet dhe për të vënë në pikëpyetje legjitimitetin dhe kërkesat për besime ekstremiste.
- ▶ T'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi për të qenë elastikë, për t'iu rezistuar ideve e qëndrimeve ekstremiste dhe për të përfutur aftësitë social-emocionale që iu duhen, për të kapërcyer dyshimet që kanë dhe për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive në shoqëri, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar dhunës.
- ▶ Të formojë qytetarë të informuar, të aftë për të të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në masa kolektive paqësore.

Për UNESCO-n, kjo është e mundur përmes Edukimit për Qytetari Globale (Global Citizenship Education, GCED), i cili kërkon të ushqejë ndjenjën e përkatësisë në një botë të përbashkët si dhe respektin për të gjithë.

ÇFARË ËSHTË QYTETARIA GLOBALE?

Qytetaria globale nënkupton ndjesinë e përkatësisë në komunitetin global dhenë bashkësinë njerëzore të përbashkët, anëtarët e të cilës përjetojnë solidaritet dhe identitet kolektiv ndërmjet tyre dhe përgjegjësi kolektive në nivel global.

GCED-ja është një qasje në zhvillim e sipër për arsimimin, e cila përqendrohet tek njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve nga këndvështrimi i pjesëmarrjes së tyre aktive në zhvillimin paqësor dhe të qëndrueshëm të shoqërive të tyre.

GCED-ja ka të bëjë me respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtësisë sociale, të barazisë gjinore dhe të qëndrueshmërisë mjedisore, të cilat janë vlera themelore që ndihmojnë në rritjen e mbrojtjes së paqes kundrejt ekstremizmit të dhunshëm.¹²

¹² [Edukimi për Qytetari Globale – Temat dhe objektivat e të nxënësve, UNESCO, 2015, http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002329/232993e.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002329/232993e.pdf) dhe [Edukimi për Qytetari Globale – Përgatitja e nxënësve për sfidat e shekullit të njëzet e një, UNESCO, 2014, http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002277/227729e.pdf](http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002277/227729e.pdf)

2.3 SHFAQJET LOKALE TË EKSTREMIZMIT

Shumë nxënës kanë pak lidhje me ngjarjet ndërkombëtare ose janë të keqinformuar rreth tyre. Për këtë arsye, diskutimi i shfaqjeve lokale të ekstremizmit të dhunshëm, përveç formave ndërkombëtare të fenomeneve ose në vend të tyre, sjell përfitime të mëdha.

Diskutimi i manifestimeve lokale të ekstremizmit të dhunshëm ...

- ▶ i ndihmon nxënësit të kuptojnë lidhjet ndërmjet sfidave lokale dhe globale.
- ▶ i ndihmon ata të kuptojnë rreziqet reale dhe pasojat e ekstremizmit të dhunshëm.
- ▶ iu demonstron të rinjve se ata mund të sjellin një ndryshim, në se bëjnë zgjedhjet e duhura brenda konteksteve të tyre.

Megjithatë, diskutimi i çështjeve kundërshtuese kërkon të mbahen parasysh:

- ▶ Lidhja e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm me përmbajtjen e kurrikulës lokale.
- ▶ Kuptimi i larmisë shoqërore, kulturore, etnike dhe fetare të kontekstit lokal.
- ▶ Përfshirja në diskutim e këndvështrimeve të pakicave ose, të paktën, sigurimi i përfaqësimit të pikëpamjeve të tyre, në mënyrë të tillë, që të rinjve t'iu mundësohet njohja me larminë e trajtimit të çështjeve.
- ▶ Qartësia për rolin e mësuesit si moderator (zë objektiv, “avokati i djallit”, lehtësues i paanshëm etj.).
- ▶ Përcaktimi i kohës së diskutimit, pasi çështjet e debatueshme nuk duhet të diskutohen kuturu.

Në disa raste, diskutimi i shfaqjeve lokale të ekstremizmit mund të jetë shumë kompleks dhe i ndjeshëm. Në këto rrethana, diskutimi mund të ketë më sukses nëse tema paraqitet përmes një shembulli, i cili nuk lidhet hapur me sfidat me të cilat përballen nxënësit lokalë.

SHEMBULL

UNESCO-ja dhe Muzeu Memorial i Holokaustit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilluan në vitin 2015 një program të ri trajnimi me titull, *Konferenca për Edukimin Ndërkombëtar për Holokaustin*, që kishte si qëllim të ndihmonte aktorët e arsimit nga të gjitha anët e botës, për zhvillimin e pedagogjive të reja për trajtimin e çështjes së Holokaustit, për trajtimin e të shkuarës së tyre traumatike për shkak të gjenocidit dhe të krimeve kundër njerëzimit. Kjo qasje ka rezultuar efektive veçanërisht për komunitetet që kanë vuajtur nga masakrat masive.

4 ROLI I KOMUNITETIT, I FAMILJES DHE I MEDIAS

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit duhet të jetë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë parandaluese, në të cilën të përfshihet familja, komuniteti dhe media. Ndërtimi i rrjeteve të mbështetjes dhe kujdesit, të cilat i shtrijnë më tej këto fusha, rrit shanset e një ndikimi pozitiv dhe zhvillon mirëqenien e komunitetit, pa u përqendruar vetëm tek mbikëqyrja.

SHEMBUJ TË PROJEKTEVE NDËRSEKTORIALE TË KOMUNITETIT:

► **Projekti Exit**– i themeluar nga Qeveria e Norvegjisë, ka tri objektiva kryesore: të krijojë rrjete lokale për të mbështetur prindërit e fëmijëve të përfshirë në grupe raciste dhe të dhunshme; t'i nxisë të rinjtë që të mos përfshihen në këto grupe; të zhvillojë dhe të shpërndajë njohuri metodologjike për profesionistët që punojnë me të rinjtë që bashkohen me grupet e dhunshme. Projekti bazohet në bashkëpunimin ndërmjet prindërve, nëpunësve për kujdesin ndaj fëmijëve, policisë, mësuesve dhe punonjësve të rinj lokalë.

<https://www.counterextremism.org/resources/details/id/665/project-exit-leaving-violent-groups>

► **Gratë pa Kufij**– OJQ austriake që merret me fuqizimin e nënave dhe familjeve në vende të ndryshme, për të zbuluar shenja të hershme të radikalizimit dhe për t'u përballur me ndikimin e faktorëve të cilët mund t'i çojnë të rinjtë drejt ekstremizmit të dhunshëm.

www.women-without-borders.org

► **Connect Justice**– Një ndërmarrje e pavarur sociale, me seli në Mbretërinë e Bashkuar, e cila krijon zgjidhje për drejtësinë sociale, të drejtuar nga komuniteti. Fokusi i veprimit është ndërtimi i besimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, shoqërisë civile, agjencive shtetërore dhe sektorit privat rreth ekstremizmit dhe shfrytëzimit.

<http://www.connectjustice.org>

3. Menaxhimi i diskutimit në klasë

3.1 OBJEKTIVAT

Diskutimi rreth ekstremizmit të dhunshëm duhet të kërkojë të zhvillojë sa më shumë të jetë e mundur gamën e plotë të aftësive që mundësojnë pjesëmarrjen më të gjerë të nxënësve në jetën civile si qytetarë të informuar globalë.

Kjo kërkon që objektivat e të mësuarit të mbulojnë tri fushat e mëposhtme: fushën njohëse, social-emocionale dhe atë të sjelljes.

SHEMBUJ TË OBJEKTIVAVE TË TË NXËNIT SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT

FUSHAT E TË NXËNIT	OBJEKTIVAT E TË NXËNIT NGA DISKUTIMI	ATRIBUTET E NXËNËSIT, ose veçoritë dhe cilësitë që do të zhvillohen përmes diskutimit.
	Nxënësi duhet:	Nxënësi:
FUSHA E NJOHJES	<ul style="list-style-type: none"> ▶ të zhvillojë aftësitë për të menduar dhe për të analizuar në mënyrë kritike; ▶ të fitojë njohuri dhe të kuptojë çështjet lokale, kombëtare dhe globale dhe për ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e vendeve dhe popullsive të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Njeh format e manipulimit. ▶ Është i vetëdijshëm i për llojet e stereotipave, tëparagjytimeve dhe perceptimeve paraprake dhe për ndikimin e tyre. ▶ Është i aftë për të bërë dallimin ndërmjet faktit dhe opinionit dhe për të dyshuar burimet e tyre. ▶ Është i informuar për format e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe për çështje të tjera globale. ▶ Kupton kompleksitetin e çështjeve të tilla.
FUSHA SOCIO-EMOTIONALE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ të përjetojë ndjenjën e përkatësisë në një grup shoqëror, me vlera e përgjegjësi të përbashkëta, të mbështetura tek të drejtat e njeriut ▶ të zhvillojë ndjenjën e empatisë, të solidaritetit dhe të respektit për të ndryshmet dhe laërminë; ▶ të zhvillojë kompetencat ndërkulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Vlerat e tij themelore mbështeten në të drejtat e njeriut . ▶ Respekton diversitetin ▶ Është i aftë të dallojë emocionet që përjetoohen nga persona të tjerë. ▶ Interesohet për të mënyrën e jetesës dhe kulturën e personave të ndryshëm. ▶ Është i aftë të ndërveprojë me "efektivitet dhe siç duhet me persona të ndryshëm nga pikëpamja gjuhësore dhe kulturore,"¹³

13 Kompetencat ndërkulturore – Kuadri konceptual dhe Operativ, <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002197/219768e.pdf>

SHEMBUJ TË OBJEKTIVAVE TË TË NXËNIT SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT

FUSHAT E TË NXËNIT	OBJEKTIVAT E TË NXËNIT NGA DISKUTIMI	ATRIBUTET E NXËNËSIT, ose veçoritë dhe cilësitë që do të zhvillohen përmes diskutimit.
	Nxënësi duhet:	Nxënësi:
FUSHA E SJELLJES	<ul style="list-style-type: none"> ▶ të veprojnë me efektivitet dhe përgjegjësi gjatë diskutimit; ▶ të shprehet me vetëbesim dhe të trajtojë konfliktin në mënyrë pozitive; ▶ të zhvillojë motivet dhe gatishmërinë për marrjen e masave të nevojshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ është në gjendje të dëgjojë me respekt pikëpamjet e ndryshme; të shprehë mendimet vetjake dhe t'i vlerësojë të dyja; ▶ shpreh dëshirën për të marrë veprime të përgjegjshme.

3.2 PËRGATITJA

■ PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËRGATITJA?

- ▶ Përgatitja paraprake ul frikën e diskutimit të temave kundështuese në çdo rast që ato shfaqen.
- ▶ Një aspekt i rëndësishëm i përgatitjes është zhvillimi i një plani për diskutimin, i cili ravijëzon qartë përfitimet edukative të kësaj pëvoje.

■ ÇFARË DUHET PËRGATITUR?

- ▶ Objektivat e të mësimit, temat/pikat e ndëhyrjes, qasja e diskutimit dhe mesazhet kryesore të përmbajtjes që duhet të transmetohen me anë të bisedës duhen të formulohen paraprakisht.
- ▶ Duhet të sigurohen miratimet e nevojshme, pasi roli i drejtorëve dhe administratorëve të shkollave është kyç për të sigurua mbështetjen për trajtimin e temave të tilla. Në varësi të kontekstit, mund të jetë i nevojshëm edhe vlerësimi i nxënësve ose miratimi i tyre.
- ▶ Mund të jetë me vlerë që materialet informuese për temën të rishikohen përpara diskutimit. Kjo do të ndihmonte në trajtimin e keqkuptimeve dhe miteve, përmes gjetjes paraprake të fakteve që lidhen me to.

KËSHILLA

- ▶ Parashikoni sfidat dhe mundësitë për diskutim.
- ▶ Zhvilloni biseda me të rritur të tjerë në shkollë dhe në komunitetin lokal, siç janë prindërit dhe mësuesit, për mënyrën e trajtimit të temës së ekstremizmit të dhunshëm, pasi kjo mund t'iu ndihmojë.
- ▶ Mos u përfshini në një bisedë, në qoftë se nuk ndiheni emocionalisht dhe profesionalisht të gatshëm për ta bërë këtë gjë.
- ▶ Përfytyroni njërin prej nxënësve tuaj si dhe bisedën që mund të zhvilloni me të para se ajo të ndodhë.
- ▶ Në varësi të përbërjes së shkollës/komunitetit, mund të jetë e dobishme që të ftohen në klasë njerëz me prejardhje të ndryshme nga ajo e nxënësve dhe e anëtarëve të stafit.
- ▶ Nëse është e nevojshme, mund të ftohet një profesionist i specializuar për ndërmjetësimin, për të ndihmuar, veçanërisht në diskutimet e çështjeve të ndjeshme.

3.3 DISKUTIMI

■ KUR ËSHTË E KOHA E PËRSHTATME PËR DISKUTIM?

Gjetja e kohës dhe e çastit të duhur për nisur një diskutim për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm në klasë kërkon përgatitje dhe maturi.

Ndërsa mësimet dhe diskutimet mund të planifikohen paraprakisht dhe të zbatohen si pjesë e mësimit të ditës, çastet e tjera të hyrjes në një diskutim mund të lindin befas. Këto janë "çaste të arta për të mësuar". Ato mund të vijnë atëherë kur nuk i pret. Ato janë mundësi të paplanifikuara që duhet të kapen dhe të përdoren për të shpjeguar një koncept të vështirë ose për të filluar një bisedë, e cila e lidh temën me përvojat e nxënësve.

Këto çaste mund të kthehen në mundësi të humbura nëse mësuesit nuk janë të përgatitur personalisht dhe profesionalisht për t'i përdorur siç duhet ato.

KËSHILLA

Një ndër aftësitë më të rëndësishme që mund të zotërojë një mësues është aftësia për të njohur dhe për t'i përdorur "çastet e arta për të mësuar nxënësit" për të zhvilluar një mjedis të sigurt dhe të besuar. Këto çaste përbëjnë kohën ideale për t'u mësuar nxënësve një mësim¹⁴ të rëndësishëm. Çaste të tilla mund të ndodhin pothuajse kudo dhe në çdo kohë: rrugës për në shkollë, në këndin e lojërave, në lokalin e shkollës, dhe në klasë.

► Mësuesit mund të mos kenë kohë që të shqyrtojnë tërësisht rregullat dhe udhëzimet për një diskutim gjatë një çasti të tillë me nxënësit. Diskutimi i një çasti të tillë të artë shpesh ndodh pas një incidenti që e provokon atë. Mësuesit mund t'i përgatisin nxënësit duke marrë pjesë rregullisht në diskutime dhe në dialog në klasë, në pritje të këtyre çasteve të paplanifikuara e frymëzuese.

► Diskutimi për çastet e arta për të mësuarit mund të përqendrohet tek vlerat dhe tek aftësitë e të mësuarit akademik.

► Kushtojini vëmendje situatës dhe bëhuni dëgjues të mirë. Disa prej çasteve të arta për të mësuarit nuk janë aq të dukshme sa të tjerat.

► Bëhuni krijues. Një diskutim për çastet e arta për të mësuarit mund të dalë dhe nga përvojat negative. Nëse një fëmijë e quan një fëmijë tjetër "terrorist", ose i vë një nofkë tjetër, përdoreni incidentin për të mësuar në lidhje me përdorimin e nofkave, respektin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

► Mësuesit mund t'i përdorin këto biseda për të nisur diskutimin për çastet e arta për të mësuarit në klasë.

a. "Çfarëka ndodhur? Pse ndodhi kjo?"

b. "Dikush bëri diçka të këndshme për dikë tjetër. Kush e gjen se çfarë bëri?"

14 Ballenger, C. 2009. *Puzzling moments, teachable moments: Practicing teacher research in urban classrooms*. Neë York, Teachers College Press (Practitioner Inquiry Series, edicioni i parë 1).

c. “Le të flasim për respektin sot.”

d. “Pse mendoni se është e rëndësishme të flasim për atë që ndodhi në klasë sot?”

► Përfundoni diskutimin e nxitur nga çasti i artëpër të mësuarit:

a. “Çfarë mësuat sot? Pse ishte i rëndësishëm ky diskutim?”

b. Më pas, përfshijeni klasën në njëveprimtari që i pëlqen si, për shembull, nëveprimtari sportive ose nënjë dramë, për të rritur miqësinë dhe bashkëpunimin, veçanërisht nëse diskutimi u shoqërua me përjetime negative.

c. Jini në dispozicion të nxënësve dhe të prindërve për ndjenja të paqartësuar, pyetje ose komente të lindura gjatë diskutimit.

■ CILAT JANË RREGULLAT BAZË?

Pavarësisht nëse diskutimi është i planifikuar paraprakisht apo jo, është e rëndësishme që të zhvillohen disa rregulla bazë, të cilat bëjnë të mundur që diskutimi të rrjedhë në mënyrë të sigurt dhe në një mjedis të respektueshëm të të mësuarit.

Një prej mënyrave për të ndërtuar komunitetin e klasës është që mësuesit dhe nxënësit të hartojnë bashkërisht një listë të rregullave bazë për të drejtuar procesin e diskutimit.

Pasi të jenë propozuar të gjitha rregullat, duhet të miratohen vetëm ato rregulla për të cilat bie dakord pjesa më e madhe e klasës. Rishikojini rregullat bazë dhe ngjitini ato në një vend të dukshëm përpara fillimit të diskutimit.

SHEMBUJ TË RREGULLAVE BAZË PËR DISKUTIMIN

1. Dëgjoni me kujdes, pa gjykuar dhe me mendje të hapur.
2. Kërkoni sqarime në rastet kur nuk kupton diçka.
3. Kritiko ose vër në dyshim komentet, idetë ose qëndrimet, por jo personin që i bën ato.
4. Jini i gatshëm për të pranuar mendime ose kritika për idetë tuaja.
5. Tregoni respekt për pikëpamjet që janë të ndryshme nga të tuat.
6. Përdorni gjuhë të respektueshme, jo të fryrë. Shmangni fjalët që janë të ngarkuara politikisht ose të ngarkuara me dhunë.
7. Respektoni qëndrimet, ndjenjat dhe këndvështrimet e të tjerëve për çështjen.
8. Jepuni kohë edhe të tjerëve të flasin, respektoni radhën dhe mos i ndërprisni ata.
9. Përfshijini të gjithë në diskutim, sidomos ata të cilëve mund t'u mungojë besimi ose gatishmëria për të folur.
10. Qëndroni në temë dhe bëj komente të shkurta.

■ SI TË BËSH PYETJE?

Si lehtësues, për t'i ndihmuar nxënësit gjatë diskutimit, shërbeni si model për mënyrën e të pyeturit dhe marrjen e përgjigjeve. Bëni pyetje zbuluese dhe kritike, të cilat i ndihmojnë nxënësit të eksplorojnë pikëpamje alternative.

Dhënia e shembujve për mënyrën e të pyeturit do t'i shtyjë nxënësit drejt zbatimit të këtij modeli.

SHEMBUJ TË PYETJEVE TË CILAT MUND TË BËHEN PËR TË SQARUAR DEKLARATAT E BËRA NGA NXËNËSIT

1. A mund të na shpjegoni se çfarë doni të thoni me këtë, pasi mendoj që nuk e kuptova si duhet?
2. A mund ta konkretizoni me një shembull?
3. Cili është fakt dhe çfarë është opinion në këtë deklaratë?
4. Nga e di se? Ku e bazoni gjykimin tuaj?
5. Çfarë rrjedh, në mënyrë logjike, nga ky argument ose deklaratë?
6. Si lidhet shembulli që na dhatë me çfarë mësuam sot?
7. Cili është dallimi ndërmjet dhe ...?
8. A mund të na shpjegoni, ju lutem, pse mendoni se kjo është e rëndësishme?
9. A ka ndonjë pikëpamje tjetër për këtë çështje?

■ TË MËSOJMË TË DËGJOJMË PA GJYKUAR

Të rinjtë janë të etur për shanset për të diskutuar çështje me një dëgjues, i cili nuk i gjykon. Ata janë të mbushur me ide, disa të arsyeshme dhe disa më pak të arsyeshme. Ata kanë nevojë që dikush t'ua dëgjojë idetë, t'u sugjerojë mënyra të tjera të të menduarit dhe t'i ndihmojë të ideojnë vendime të arsyeshme, të cilat marrin parasysh pasojat e rëndësishme afatgjata.

- ▶ Shmangni dënimin ose paragjykimin e nxënësit gjatë diskutimit për shkak të zërit, shqetësimeve, veprimeve ose qëllimeve të tij ("nuk mund ta thuash këtë gjë ...", "nuk mund të mendoni se ...").
- ▶ Shmangni pozicionimin e vetes si autoriteti kryesor për temën në diskutim. Përkundrazi, luani rolin e lehtësuesit dhe sigurohuni që siguroni pasqyrimin e pikëpamjeve pluraliste dhe të të gjitha argumenteve të trajtuara në diskutim.
- ▶ Mundohuni të mos i ndërpresni nxënësit teksa ata zhvillojnë argumentet e tyre. Përkundrazi, ndihmojini ata të gjejnë fjalë për të shprehur mendimet që kanë.
- ▶ Jepuni sugjerime të ndjeshme dhe me respekt lidhur me çështjet që duhet të shqyrtohen, duke përfshirë dhe pasojat morale dhe etike të vendimeve.
- ▶ Kujdes, mos i interpretoni më shumë seç duhet komentet e debatueshme ose raciste si shenja të ekstremizmit të dhunshëm.

KËSHILLA

- ▶ Qëndroni i përqendruar – mbajeni diskutimin të përqendruar tek tema dhe objektivat e të mësuarit. Në rast se diskutimi shpërndahet në fusha të tjera, cilësia e diskutimit do të cenohet. Roli i lehtësuesit është që, në rast devijimi, ta kthejë diskutimin tek tema kryesore, duke siguruar përmbushjen e objektivave të të mësuarit.
- ▶ Jepni modelin e një sjelljeje me respekt dhe qytetare përmes veprimeve që kryen – nxënësit do ta vënë re sjelljen tuaj dhe do ta ndryshojnë sjelljen e tyre sipas saj. Në rast se lehtësuesi flet me respekt dhe me kujdes në kuadrin e dialogut, edhe nxënësit do ta pasqyrojnë atë. Respektoni rregullat e diskutimit. Buzëqeshni aty ku është e përshtatshme. Mos caktoni fajtorin, mos thoni haptazi pikëpamjen kundër ose mos qortoni.
- ▶ Vini re sjellje agresive verbale dhe joverbale gjatë diskutimit. Në rast se vëreni një sjellje të tillë, përgjigjuni siç duhet, duke u bazuar në rregullat dhe pasojat për të cilat është rënë dakord. Në rast se kjo sjellje zgjat, këshillohet që diskutimi të vazhdojë një herë tjetër. Agresiviteti është më mirë të trajtohet me qasje proaktive. Ndhimoi nxënësit që të ideojnë një diskutim efektiv përmes lojës me role dhe modelimit të strategjive aktive të të mësuarit.
- ▶ Nxisni dhe përforconi pozitivisht angazhimin konstruktiv në dialog.
- ▶ Nxisni nxënësit që të shkruajnë për ndjenjat dhe përvojat e tyre, në një ditar ose në një letër, për t'i ndihmuar ata që të reflektojnë më thellë për temën e diskutuar dhe të shprehin emocionet e tyre.

■ SI TË SIGUROJMË QË TË DËGJOHEN TË GJITHA KËNDVSHTRIMET?

- ▶ Është shumë e rëndësishme që diskutimi të strukturohet në mënyrë të tillë që të gjithëve t'iu jepet mundësia të flasin dhe që asnjë person, grup ose pikëpamje e veçantë të mos e sundojë bisedën. Ju mund të shmangni të folurit e tepruar prej mësuesi dhe siguroni që të dëgjoen gjitha zërat, duke përdorur strategjinë "*përgjigju dhe tërhiqu*". Përgjigjuni një pyetje ose deklaratë të bërë nga nxënësit, por më pas "*tërhiquni*" ose "*hidhjeni topin*" një ose më shumë nxënësve.
- ▶ Është e rëndësishme të siguroni që asnjë nga grupet të mos përjashtohet nga diskutimi dhe se të gjithë, vajzat dhe djemtë dhe grupet e pakicave të përfshihen në diskutim dhe të ndihen të sigurt për të marrë pjesë aktivisht në të.
- ▶ Është e rëndësishme që nxënësit të ndihmohen të kuptojnë se shumë nga problemet e botës janë komplekse dhe shumëplanëshe. Problemet e ngritura mund të mos kenë një përgjigje "*të drejtë ose të gabuar*", por mund të përmbajnë shumë kompleksitete, nënkuptime dhe paqartësi.

3.4 TEMAT PËR TRAJTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Ka shumë lëndë të cilat mundësojnë një diskutim të frytshëm rreth ekstremizmit të dhunshëm. Sfida që shtrohet është si të formulohet tema në mënyrë të tillë që t'u vijë në ndihmë nxënësve për të eksploruar vlerat dhe opinionet e tyre dhe për të menaxhuar përgjigjet emocionale, ndërkohë që kuptojnë më mirë idetë bazë të ideologjive ekstreme.

Ndër këto lëndë përmendim:

- ▶ **Qytetaria** – Mundëson nxënësit të trajtojnë çështjet e të drejtave dhe të përgjegjësive në shoqëri të ndryshme, çështje të drejtësisë, të identitetit dhe të nocionit të "përkatësisë". Tema ofron edhe mundësi për të debatuar rreth parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe për të identifikuar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes.
- ▶ **Historia** – Edukimi rreth historisë së gjenocidit dhe barbaritë në masë, të tilla si Holokausti, janë të rëndësishme për t'i përfshirë nxënësit në reflektimin rreth fuqisë së propagandës së urrejtjes dhe të rrënjëve të racizmit, antisemitizmit dhe dhunës politike. Po ashtu, historia iu lejon nxënësve të eksplorojnë mënyrën e krijimit dhe të ndërtimit të shkrimeve historike dhe sesi ato mund të përjetësojnë konfliktin dhe paragjykimin në shoqëritë përkatëse.
- ▶ **Feja dhe besimet** – Kjo shërben për të rritur vetëdijen dhe respektimin e diversitetit brenda komunitetit dhe për të ofruar mundësi për eksplorimin e vlerave dhe besimeve të ndryshme, duke sfiduar, në këtë mënyrë, paragjykimin dhe racizmin. Këtu duhet të përfshihet diskutimi për sekularizmin dhe humanizmin, për t'iu përgjigjur miteve që njësojnë sekularizmin dhe ateizmin¹⁵ dhe dyshimit ndaj "jo besimtarëve". Duhet të theksohet se besimtarët në një rajon të caktuar nuk duhet të stereotipizohen të gjithë të njëjtë, kur shpesh brenda një fejeke më shumë diversitet sesa ndërmjet feve të ndryshme. Është e rëndësishme që në diskutim të përfshihen dhe nxënësit që nuk kanë besime fetare.

15 Shih Davies, L. 2014. *Unsafe Gods: Security, secularism and schooling*. Londër, IOE/Trentham.

- ▶ **Gjuhët** – Ndhmon nxënësit të zbulojnë një gamë të gjerë kulturash, vlerash dhe pikëpamjesh për historinë dhe mendimin botëror. Përveç zhvillimit të aftësive bazë të të shkruarit dhe të argumentimit me gojë, gjuhët ndihmojnë për të zhvilluar edhe njohuritë për median.
- ▶ **Liria e shprehjes dhe interneti** – Ndhmon për të eksploruar me nxënësit mënyrën: si ofrohet, strukturohet dhe transmetohet informacioni; si mund të manipulohet informacioni për qëllime të dhunshme; si konkurrojnë burimet e reja të informacionit me median profesionale. Trajtimi i njohurive të medias *online* do t'u vijë në ndihmë nxënësve të përdorin internetin dhe median sociale në mënyrë të sigurt dhe të efektishme. Kjo mund të lidhet me edukimin për qytetari për të drejtat e njeriut dhe me dallimin ndërmjet fjalimeve të lira dhe të ligjshme dhe fjalimeve të urrejtjes.
- ▶ **Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore** – Kjo temë ndihmon për të kuptuar shkakun kryesor të problemit; për të sfiduar sjellje të ndryshme rreth statusit dhe rolit të grave; për të fuqizuar njësoj si djemtë dhe vajzat për përdorimin e masave konstruktive, jo të dhunshme kundër argumenteve ekstremiste që nxisin dhunën kundër vajzave dhe grave.
- ▶ **Arti** – Ndhmon për të nxitur të kuptuarit dhe vlerat e popujve, të kulturave dhe të shprehjeve kulturore të ndryshme nga tonat. Arti mund të shihet si një gjuhë universale që i lidh komunitetet dhe kulturat në kohë dhe hapësirë. Ai ofron mundësinë për të debatuar sesi mohimi dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore dhe artistike, për shkak të ekstremizmit të dhunshëm, përbën humbje për të gjithë njerëzimin.

3.5 PËRMBLEDHJA DHE HAPAT PASUESE

Pas një diskutimi rreth ekstremizmit të dhunshëm me nxënësit, mësuesit duhet të sigurohen se nuk ka keqkuptime dhe tensione të pazgjidhura ndërmjet nxënësve. Kjo nënkupton gjetjen e kohës për të analizuar të gjithë së bashku se çfarë është kuptuar dhe mësuar nga shkëmbimi i ideve. Ky është çasti i përshtatshëm edhe për të zgjidhur çështjet e pasqaruara, të cilat kërkojnë veprimtari të thelluara dhe/ose hapa pasuese.

PYETJE PËRMBLEDHËSE:

Çfarë mësuat? A keni pyetje për ndonjë çështje tjetër? A jemi më pranë të kuptuarit të proceseve që çojnë në radikalizimin e të rinjve? Çfarë na duhet të dimë tjetër për ta kuptuar më mirë ekstremizmin e dhunshëm? Si mund ta vijojmë diskutimin?

Në rast se diskutimi është i nxehtë, këshillohet që të takoheni me nxënësit individualisht për t'i falënderuar për pjesëmarrjen në diskutim dhe për t'iu siguruar atyre se kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e veta lirshëm për aq kohë sa i respektojnë të tjerët.

PYETJET PASUESE mund t'i ndihmojnë nxënësit për të reflektuar për situatën.

Si tregohet respekt për idenë e tjetrit, edhe në rast se nuk je dakord me të? A ka ndonjë gjë që do ta bëje ndryshe pas këtij diskutimi?

Mësuesit mund të shqyrtojnë edhe mundësinë e përfshirjes në disa veprimtarive shtesë, të cilat u japin mundësinë nxënësve që ta çojnë më tej diskutimin.

SHEMBUJ TË VEPRIMTARIVE SHITESË

- ▶ Organizoni diskutime në grupe të vogla ose në grupe prej dy vetash, në mënyrë që të keni mundësi të vëzhgoni me kujdes punën e nxënësve dhe veproni në përputhje me të njëjtat rregulla si në rastet e diskutimit me të gjithë grupin.
- ▶ Jini të gatshëm për diskutime konfidenciale me nxënësit dhe familjet.
- ▶ Panelet e diskutimit: kjo veprimtari pasuese kërkon që nxënësit të kenë njohuri paraprake për ekstremizmin e dhunshëm. Qëllimi është të aftësohen nxënësit për të shprehur qëndrime të ndryshme nga tyret. Filloni duke zgjedhur vullnetarë për të marrë përsipër rolin e panelistëve në një program televiziv që i kushtohet ekstremizmit të dhunshëm sipas këndvështrimit të të rinjve. Në mënyrë ideale, nxënësve u caktohet roli që mban qëndrim të kundërt me pikëpamjet e tyre personale rreth temës. Klasa i bën pyetje panelistëve, ndërsa mësuesi shërben si moderator. Veprimtaria fillon me nxënësit panelistë, të cilët fillimisht prezantohen dhe më pas vijojnë me shprehjen e qëndrimeve përkatëse.

4. Mesazhet kryesore

Pas diskutimit rreth çështjeve kundërshtuese, është e nevojshme të theksohen mesazhe pozitive për ta mbledhur klasën rreth të njëjtit grupi vlerash. Kjo është e rëndësishme për t'u siguruar që klima e klasës mbetet produktive dhe që nxënësit ndihen të sigurt.

4.1 SOLIDARITETI

Nxënësit mund të nxiten të mendojnë në mënyrë kritike në lidhje me situatat aktuale dhe *status quo*-në dhe të bëjnë pyetje rreth tyre; të identifikojnë qasje të reja dhe krijuese për problemet e përbashkëta/globale; të gjejnë mënyra për të ndërmarrë veprime jo të dhunshme dhe konstruktive për të treguar solidaritet me të tjerët. Këto veprime mund të përfshijnë vullnetarizmin ose marrjen e më shumë informacion nga institucione të rëndësishme, nga OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë për të ndihmuar njerëzit në rrethana të vështira dhe që kanë nevojë për mbështetje.

Koncepti që qëndron në themel të Edukimit për Qytetarinë Globale (EQG) është solidariteti pavarësisht nga dallimet në moshë, gjini, kombësi ose përkatësi etnike dhe jo vetëm solidaritetet me njerëzit brenda komunitetit të afërt, por edhe me persona të tjerë jashtë këtij komuniteti. Gjetja nga mësuesi e shembujve të ngjarjeve aktuale që ilustrojnë se sa e ndëlidhur është bota, se si çështje që prekin një rën pjesë të botës mund të kenë ndikim dhe mbi pjesë të tjera të saj dhe se si dikush që jeton në një vend tjetër mund të përballet me të njëjtat sfida ose probleme si edhe nxënësit në klasë, mund t'i ndihmojë nxënësit ta kuptojnë drejt këtë nocion.

4.2 RESPEKTIMI I DIVERSITETIT

Diversiteti kulturor është tipar i përgjithshëm, nëse jo i të gjithave, i pjesës më të madhe të shoqërive shoqërive në të gjithë botën. Diversiteti është po aq i nevojshëm për njerëzimin, saç është biodiversiteti për natyrën¹⁶.

Pranimi i vlerës së brendshme të diversitetit rrjedh nga njohja e të drejtave dhe lirive themelore universale të njeriut të të tjerëve.¹⁷ Pra, respektimi i diversitetit është domosdoshmëri etike, e pandashme nga respektimi i dinjitetit njerëzor.

Respektimi i diversitetit ndihmon edhe për të kuptuar pikëpamjet kontradiktore dhe ushqen empatinë dhe dhembshurinë.

Në shoqëritë tona të larmishme, këto aftësi janë të domosdoshme për të krijuar lidhje të kuptimita ndërmjet njerëzve dhe për të identifikuar zgjidhje kolektive për mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë.¹⁸

¹⁶ Takimi i ekspertëve – Dekada Ndërkombëtare për Afrimin e Kulturave, <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002346/234607e.pdf>

¹⁷ Deklarata e Parimeve për Tolerancën, 1995, http://www.unesco.org/ëebëorld/peace_library/UNESCO/HRIGHTS/124-129.HTM

¹⁸ po aty 16.

4.3 TË DREJTAT E NJERIUT

Të mësuarit rreth të drejtave të njeriut nxit kulturën e jo dhunës dhe mosdiskriminimit dhe ndjenjat e respektit dhe të tolerancës. Arsimimi që nxit kuptimin më të mirë të të drejtave të njeriut mundëson po ashtu dhe të mësuarit kritik dhe debatin rreth ekstremizmit¹⁹ të dhunshëm. Disa prej nocioneve të shpjeguara më poshtë janë komplekse dhe mund të mos jenë të përshtatshme për nxënësit më të rinj.

- ▶ Të drejtat e njeriut janë garanci themelore dhe universale. Ato zbatohen për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga kombësia, vendbanimi, gjinia, prejardhja, feja, gjuha ose ndonjë status tjetër. Ndryshe nga të drejtat e njohura nga një shtet në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, të drejtat e njeriut zbatohen për individët nga të gjitha shtetet përtej kufijve kombëtarë.
- ▶ Të drejtat e njeriut përfshijnë si të drejta ashtu edhe përgjegjësi. Në këto koncept përfshihet dhe ideja se çdo person ka për detyrë të respektojë të drejtat e të tjerëve. Për shembull: respektimi i të drejtës së tjetrit për lirinë e mendimit, shprehjes dhe besimit.
- ▶ Për këtë arsye, është e rëndësishme që të rinjtë të kuptojnë se individët (ose grupe individësh) nuk mund të theksojnë të drejtat e tyre si justifikim për shkeljen e të drejtave të dikujt tjetër.
- ▶ Të diturit se çfarë është dhe çfarë nuk është një e drejtë e njeriut, siç përcaktohet në konventa të ndryshme ndërkombëtare, i aftëson nxënësit të kundërshtojnë pretendime të rreme dhe të kuptojnë se çfarë është e drejtë dhe çfarë kërkon mbrojtje. Për shembull: nuk ekziston e drejta për të mos u kritikuar; fetë nuk kanë të drejta, ndërsa njerëzit dhe grupet fetare po.

¹⁹ Të nxënit: Thesari i brendshëm (The Treasure Ëithin), Raport për UNESCO-n nga Komisioni Ndërkombëtar për Edukimin në Shekullin e Njëzet e Një, 1996, http://www.unesco.org/education/pdf/15_62.pdf

- ▶ Është gjithashtu me vlerë të kuptohet që, sipas konventave ndërkombëtare, nuk ka të drejta të parëndësishme. Kjo do të thotë që këto të drejta (të tilla si e drejta për jetën, e drejta kundër torturës) duhet të zbatohen pa përjashtime. Po kështu, disa të drejta të njeriut mund të kufizohen në rrethana përjashtimore (të tilla si, e drejta e lirisë së shprehjes, e drejta e lëvizjes dhe e drejta për privatësinë). Këto dallime shërbejnë për t'u ardhur në ndihmë nxënësve që të zhvillojnë të kuptuarit më të plotë të situatave komplekse. Për shembull, në rast se një grup ekstremist kryen një sulm të dhunshëm, mediet mund t'i lejohet vetëm akses i kufizuar në vendin e krimit menjëherë pas sulmit, për shkak të arsyeve të sigurisë.

4.4 TË MËSOJMË SI TË JETOJMË SË BASHKU

Të jetuarit në një botë të ndërlidhur dhe të ndërvarur nuk i pajis automatikisht individët dhe shoqëritë edhe me aftësitë që u nevojiten për të jetuar së bashku në paqe.

Të jetuarit në një shoqëri paqësore është qëllim afatgjatë, që kërkon "të kuptuarin e të tjerëve dhe të historive, traditave dhe vlerave shpirtërore të tyre", si dhe aftësinë "për të realizuar projekte të përbashkëta, ose për t'i menaxhuar konfliktet e pashmangshme në mënyrë inteligjente dhe paqësore."²⁰

Qasja e UNESCO-s për "*të mësuarit për të jetuar së bashku*" bazohet në këtë përkufizim dhe nënkupton dy procese plotësuese të të mësuarit:

- ▶ "zbulimi i të tjerëve", proces i cili përcakton bazën për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet nxënësve;
- ▶ "përvoja e qëllimeve të përbashkëta", ku nxënësit punojnë së bashku drejt përmbushjes së qëllimeve të përbashkëta.

"Të mësuarit për të jetuar së bashku" çon në zhvillimin e kompetencave dhe të aftësive kyçe, të tilla si ndjeshmëria, njohja e kulturave të tjera, ndjeshmëria kulturore, të kuptuarit e diskriminimit, pranimi, dhe komunikimi.

20 Të mësuarit si të jetojmë së bashku (Learning to Live Together), Zyra e UNESCO-s në Bangkok, 2014, 20, <http://unesdoc.unesco.org/images/0022/002272/227208e.pdf>

4.5 PËRFSHIRJA E TË RINJVE

Të rinjtë mund të nxiten të shfrytëzojnë energjinë dhe entuziazmin që i karakterizon për të krijuar dhe zhvilluar ide pozitive dhe zgjidhje të reja për sfidat dhe shqetësimet e sotme globale. Me njohuritë që kanë për krijimin e rrjeteve përmes mediave sociale, ndarja e përvojave ndërmjet tyre bëhet menjëherë realitet dhe ka potencial për t'u përhapur gjerësisht.

Përmes pjesëmarrjes aktive në organizatat rinore dhe grupet informale, të rinjtë janë në gjendje të ushqejnë ndjenjën e shpresës, identitetit, shoqërisë dhe përkatësisë, të cilat i angazhojnë ata më shumë me komunitetin.

Përfshirja në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal e qendror ose pjesëmarrja në veprimtari vullnetare ndihmojnë edhe në kultivimin e dëshirës së të rinjve dhe energjisë së tyre për ndryshim.

Shkollat mund të mësojnë aftësi që lidhen me mbështetjen, fushatat, buxhetimin, ndërtimin e organizatave dhe udhëheqjen për të lehtësuar angazhimin e të rinjve.

Proceset demokratike të zgjedhjeve priren të jenë tepër të ngadalta për të rinjtë, të cilët parapëlqejnë veprim të menjëhershëm. Për këtë arsye, duhet të identifikohen mënyra të shpejta për të krijuar ndryshim dhe ndikime pozitive mbi komunitetin.

SHTOJCË

■ PYETJE TË SHPESHTA:

***PYETJE:** Çfarë ndodh nëse nuk kam një përgjigje për shqetësimet dhe pyetjet e nxënësve?*

PËRGJIGJE: Thjesht pranojeni që nuk keni përgjigje, por mos e ndërprisni diskutimin menjëherë. Përdoreni pyetjen si pikë nisëse për të vijuar me debatin orën tjetër. Mund t'i nxisni nxënësit që ta përdorin çështjen e diskutueshme si temë për një projekt kërkimor. Është e rëndësishme që të pranoni që as ju, si mësues, nuk i keni të gjitha përgjigjet dhe se edhe ju duhet ta studioni më tej çështjen. Ushtrimi i ndershmërisë është një ndër mënyrat më të mira të të mësuarit e saj. Paraqitja e vetes si nxënës i përjetshëm mund të ndihmojë për ndërtimin e mëtejshëm të një raporti pozitiv me nxënësit. Është e rëndësishme që të mos shpërfilllet tema dhe t'u jepet nxënësve mundësia që ta trajtojnë atë në thellësi. Për ta arritur këtë gjë, duhet të kërkoni për informacion, të mblidhni informacionin e nevojshëm pas orës së mësimit dhe të konsultoheni me kolegë dhe me autoritetet e shkollës lidhur me rrugën më të mirë për ta trajtuar problemin specifik. Kur është e nevojshme, mos hezitoni të kërkoni zhvillim profesional.

***PYETJE:** A duhet t'i prek temat e ndjeshme, ose temat që quhen “tabu”?*

PËRGJIGJE : Me rritjen e aksesit ndaj informacionit dhe teknologjisë së komunikimit, mësuesit dhe prindërit mund të habiten me shkallën e ekspozimit të fëmijëve ndaj çështjeve të ndjeshme dhe me njohjen që ata kanë për ngjarjet e debatueshme botërore. Për pasojë, mësuesit nuk duhet të shmangin trajtimin e këtyre çështjeve. Nëse e bëjnë këtë gjë, nxënësit do të përpiqen të gjejnë përgjigje vetë, gjë që mund t'i çojë drejt burimeve të gabuara të informacionit dhe qasjeve. Pra, shmangja e temave nuk duhet të shtrohet si alternativë. Mësuesit duhet të ndërtojnë një mjedis të sigurt dhe konstruktiv për dialog brenda klasës dhe të sigurojnë që nxënësit të ndjejnë dhe të besojnë se pyetjet dhe shqetësimet e tyre dëgjoen si nga mësuesit, edhe nga shkolla. Kjo i bën nxënësit të diskutojnë në klasë lidhur me trajtimin e problemeve dhe dilemave të tyre. Ndërtimi i besimit është i domosdoshëm për të trajtuar çështjet tabu dhe për të vënë një gur drejt shmangies së marxhinalizimit.

PYETJE: Në klasat ku jap mësim, ka nxënës nga pakicat, të cilët mund të etiketohen si të prirur për ekstremizëm të dhunshëm. A është me vend që të diskutohet kjo çështje me ta?

PËRGJIGJE: Po, për aq kohë sa diskutimi është i barapeshuar. *Së pari*, është shumë e rëndësishme që nxënësit nga grupet e pakicave, të pranishëm në klasë, të mos njësohen me personat që kanë kryer vepra të ekstremizmit të dhunshëm dhe që i përkasin të njëjtës pakice ose grupi etnik. Vini në pah veçoritë individuale dhe personale në raport me identitetin e grupit, si dhe nevojën për të respektuar të drejtat e çdo individi. *Së dyti*, është me vlerë që të diskutohet çështja etiketimit të padrejtë, ndonjëherë, të vetë grupit të pakicës, si rrjedhojë e akteve të ekstremizmit të dhunshëm të kryer nga një ose dy individë që lidhen me këtë grup. Nxënësit duhet të kuptojnë padrejtësinë që mund të bëjnë vetë ndaj personave të pafajshëm përmes etiketimit dhe përjashtimit. *Së treti*, nga fillimi i diskutimit, mësuesi duhet të nënvizojë që ekstremizmi i dhunshëm nuk kufizohet vetëm në një grup racor, fetar, etnik, gjinor ose politik. Për këtë arsye, është e rëndësishme të paraqitet e gjithë larmia e shembujve të ekstremizmit të dhunshëm e lidhur edhe me prejardhjen e keqbërësve.

PYETJE: A duhet ta trajtoj temën e ekstremizmit të dhunshëm kur nxënësit nuk janë shumë të prekur ose të interesuar për këtë dukuri, ashtu si ajo paraqitet dhe trajtohet në media?

PËRGJIGJE: Qëllimi i mësimdhënies rreth ndikimit të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe nxitja e diskutimeve të hapura për parandalimin e tij, nuk ka të bëjë vetëm me lehtësimin e pasojave të menjëhershme të ekstremizmit. Ekstremizmi i dhunshëm ka të bëjë, *së pari* dhe mbi të gjitha, me shkeljen e vlerave bazë universale, të tilla si: të drejtat e njeriut, mos ushtrimi i dhunës dhe mosdiskriminimi. Masat parandaluese përfshijnë, ndër të tjera, mësimi i vlerave pozitive për nxënësit dhe aftësimi i tyre për të kundërshtuar idetë dhe ndikimet ekstremiste me të cilat ndeshen, edhe pse, aktualisht, mund të duket sikur ata nuk janë të prekur prej tyre. Edukimi për qytetari globale është një ndër konceptet bazë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe bazohet në të mësuarit e dhembshurisë dhe të përgjegjësisë ndaj individëve që nuk i njohin dhe që, ndoshta, nuk do t'i njohin kurrë. Përgatitja e mendësisë së respektimit të diversitetit dhe të karakteristikave unike të njerëzve përfaqëson një ndër objektivat më të rëndësishme të arsimit cilësor për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

PYETJE: A duhet t'i përqendroj diskutimet në një tip/rast/shembull lokal të ekstremizmit të dhunshëm?

PËRGJIGJE: Përfshirja e shembujve lokalë të ekstremizmit gjatë diskutimeve në klasë mund të ndihmojë për

ta bërë temën më të prekshme nga nxënësit, por edhe mund të çojë në rritjen e ngarkesave emocionale dhe të stresit të nxënësit. Përveç kësaj, në këtë rast, ekziston edhe rreziku i etiketimit të grupeve të caktuara të nxënësve. Për rrjedhojë, është e rëndësishme që kjo çështje të trajtohet në mënyrë të baraspeshuar e të kujdesshme. Për këtë qëllim, mund të përdoren edhe shembuj të ekstremizmit të dhunshëm nga tekstet shkollore, nga vende të tjera ose nga vetë komuniteti i mësuesit. Për aq sa është e mundur, mësuesi duhet të përzgjedhë shembuj të larmishëm, për të parandaluar të kuptuarit, që ka në bazë stereotipat, e ekstremizmit të dhunshëm lidhur me një grup të caktuar të nxënësve. Kur trajtohet një shfaqje lokale e ekstremizmit të dhunshëm, mësuesi mund ta trajtojë atë në nivelin konceptual, duke iu referuar shkaqeve dhe shtytësve të ndryshëm të mundshëm që kanë çuar në ekstremizëm dhe në pasojat e mundshme të tij. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit që të distancohen emocionalisht nga çështja/rasti dhe të ulin përfshirjen personale në trajtimin e saj, gjë që do të pengonte debatin e hapur dhe konstruktiv.

PYETJE: *Si t'i parandaloj konfliktet që mund të krijohen ndërmjet nxënësve me pikëpamje të ndryshme, gjatë dhe pas diskutimit në klasë?*

PËRGJIGJE: *Është e rëndësishme që procesi i diskutimit të ekstremizmit të dhunshëm të përmbillet në kuadrin e një cikli të strukturuar. Për këtë arsye, është e nevojshme që diskutimi të paraprihet me një fazë përgatitore si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Rregullat bazë duhet të përcaktohen që në fillim. Mësuesi duhet t'i përcaktojë qartë kufijtë e asaj që lejohet e asaj që nuk lejohet. Nxënësit nuk duhet të krijojnë ndjesinë që nuk u dëgjohet zëri, që po shmanget diskutimi i thelluar ose që diskutime të tilla ndërpriten menjëherë sapo përmenden. Pra, diskutimet përmbledhëse dhe përmbyllëse janë elementë po aq të rëndësishëm sa dhe faza e përgatitjes. Të ndjerit dhe përjetimi i debatit si proces demokratik dhe i hapur, ku të gjithë nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, është proces po aq i kuptimtë dhe i rëndësishëm sa edhe vetë përmbajtja e diskutimit. Në rast se nxënësit shohin që mendimet e tyre dëgjohen dhe respektohen, ka më pak të ngjarë që ata të konfliktohen më pas. Gjatë diskutimit, mund të jetë me vlerë, që të gjendet koha për t'iu kujtuar nxënësve që ngacmimi ose dhuna në shkollë nuk tolerohet në asnjë rrethanë. Nëse është e nevojshme, mësuesi mund të përmendë çështje të pazgjidhura që kërkojnë shqyrtim të thelluar ose veprimtari të tjera në vazhdim dhe të vijojë bisedën në një kohë tjetër.*²¹

²¹ Ndalimi i Dhunës në Shkollë – Udhëzues për mësuesit (Stopping Violence in Schools: A guide for teachers), UNESCO 2009, <http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001841/184162e.pdf>

PYETJE: Si ta trajtoj çështjen e propagandës ekstremiste online?

PËRGJIGJE: Është shumë e rëndësishme që çështja e propagandës *online* të trajtohet në mënyrë të hapur gjatë diskutimit për ekstremizmin e dhunshëm. Ndonëse propaganda nuk përbën një instrument të ri për shpërndarjen e ideve ekstremiste dhe të dëmshme, ndikimi i saj sot është rritur, për shkak të mundësive që krijon interneti. Për rrjedhojë, sot bëhet më e nevojshme që propaganda të trajtohet sa më herët, duke kultivuar aftësitë e të menduarit kritik dhe duke i nxitur nxënësit që të vënë në dyshim burimin e informacionit dhe motivet e personave që botojnë materiale ekstremiste *online*. Paraqitja e koncepteve të tilla si “*qytetaria dixhitale*” dhe theksimi i rëndësisë së sjelljes së përgjegjshme, jo vetëm në realitet, por edhe *online*, duhet të jetë pjesë e programit të shkollës për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm. Ndërkohë, mësuesi mund të dëshirojë që të përdorë, në mënyrën më të mirë të mundshme, burimet arsimore *online* për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Këto burime mund të përdoren për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e nxënësve (shih seksionin e Referencave).

Referencat

Për një gamë të gjerë burimesh dhe materialesh edukative, i inkurajojmë lexuesit që të konsultohen me faqen e internetit të UNESCO-s për Edukim Global për Qytetarinë që mirëpritet nga APCEIU [në adresën http://gcedclearinghouse.org/](http://gcedclearinghouse.org/)

■ REFERENCAT KRYESORE PËRFSHIJNË:

Global Counter-Terrorism Forum. *The Abu Dhabi Memorandum on Good Practices for Education and Countering Violent Extremism*. https://www.thegctf.org/documents/10162/159880/14Sept19_GCTF+Abu+Dhabi+Memorandum.pdf

Hedayah. 2013. *The Role of Education in Countering Violent Extremism*. <http://www.hedayah.ae/pdf/role-of-education-in-countering-violent-extremismmeeting-report.pdf>

OSCE/ODIHR/YAD VASHEM. 2007. *Addressing Antisemitism: Why and How? A Guide for Educators*.

OXFAM. 2015. *Global Citizenship Education, a guide for teachers*.
<http://www.oxfam.org.uk/education/global-citizenship/global-citizenshipguides>

OXFAM. 2006. *Teaching controversial issues, a guide for schools*.
<http://www.oxfam.org.uk/education/teacher-support/tools-and-guides/controversial-issues>

- Radicalization Awareness Network. 2015. *Preventing Radicalisation to Terrorism and Violent Extremism*.
http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/ran_collection-approaches_and_practices_en.pdf
- UNESCO. 2015. *Global Citizenship Education. Topics and Learning Objectives*.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002329/232993e.pdf>
- UNESCO. 2014. *Teaching Respect For All: Implementation Guide*.
<http://www.unesco.org/new/en/education/themes/leading-the-internationalagenda/human-rights-education/resources/projects/teaching-respect-for-all/>
- UNESCO. 2013. *Intercultural Competences – Conceptual and Operational Framework*.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002197/219768e.pdf>
- UNESCO. 2009. *Stopping Violence in Schools*.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001841/184162e.pdf>
- UNESCO Bangkok, *Fostering Digital Citizenship through Safe and Responsible Use of ICT: A review of current status in Asia and the Pacific as of December 2014*.
http://www.unescobkk.org/fileadmin/user_upload/ict/SRU-ICT/SRU-ICT_mapping_report_2014.pdf
- United Kingdom Department for Children, Schools and Families. 2008. *Learning Together to be Safe. A toolkit to help schools contribute to the prevention of violent extremism*.
http://dera.ioe.ac.uk/8396/1/DCSF-Learning%20Together_bkmk.pdf

